



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

## **Study program    Biznes dhe Ekonomi**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180 / 240
Kodi	N-BABE/N-BABE-MM
Titulli	I diplomuar në Biznes dhe Ekonomi / Drejtimi: Menaxhment dhe Marketing
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-621/8
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-1619/20 (18.12.2017)
Vendimi për fillim me punë	03-1619/20 (18.12.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

## **Përshkrimi i programit**

Programi studimor Biznes dhe ekonomi paraqet kombinim të barazpeshuar të njohurive bazë teorike dhe të shkathtësive specifike profesionale. Struktura e programit përfshin studime të cilat nga natyra janë dinamike dhe interaktive. Programi është i dizajnuar të ofrojë tema nga lëmi i ekonomisë dhe menaxhmentit, duke bërë implementimin e konceptit në fjalë përmes programit studimor. Lëndët të cilat janë të përfaqësuara në këtë program paraqesin perspektiva të cilat bazohen mbi teorinë e cila është e ndërlidhur ngushtë me implementimin praktik në botën e biznesit. Ky program u mundëson studentëve përvetësim të aftësive dhe përvojave të nevojshme për: teoritë ekonomike, përdorimin e menaxhmentit, financave si dhe analizë ekonometrike të të dhënave.

Programi studimor ka për qëllim:

- T'i përgatisë studentët për pozita të liderëve në organizata profitabile apo joprofitabile në vend dhe çdo kund në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtim të karrierës në lëmin e ekonomisë dhe menaxhmentit, por edhe të sektorit privat në lëmin e financave.
- Të mundësojë përvetësim të aftësive dhe përvoja hulumtuese për: teoritë ekonomike, përdorim të menaxhmentit, financave si dhe analizë ekonometrike të të dhënave.
- Ta zhvillojë konceptin e punës praktike tek studentët.
- Ta zhvillojë konceptin e të menduarit kritik tek studentët.
- T'u mundësojë studentëve të kyçen në mënyrë aktive në ligjëratat me qëllim që në mënyrë të pavarur t'i kryejnë hulumtimet në të gjitha fushat e ekonomisë dhe menaxhmentit.
- Të mundësojë zhvillim të aftësive personale, komunikuese, hulumtuese dhe aftësive të tjera që janë të rëndësishme për punësim.

Gjatë kohës së studimeve, studentëve u jepen mundësi për punë praktike (internship), me çka ata do të aftësohen t'i implementojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëmi.

## **Karriera**

Programi studimor Biznes dhe ekonomi do t'u mundësojë studentëve:

- Të fitojnë një arsimim të përgjithshëm në disiplina që nënvizojnë teorinë dhe praktikën e menaxhmentit ndërsa nga ana tjetër ende ngelen të specializuarit në ekonomi.;
- Të ndërmarrin studim të thelluar të ekonomisë me opsionet e menaxhmentit që do t'u mundësojë të shikohen në mënyrë kritike çështjet e menaxhmentit;
- Të fitojnë trajnim në parimet e ekonomisë dhe aplikimeve të tyre;
- Ta kuptojnë se menaxhmenti është një shkencë me bazë të gjerë sociale dhe fushë multidisiplinare;
- Të njihen me mjetet e përshtatshme të analizës për të trajtuar çështje dhe problematika të politikave ekonomike;
- T'i kuptojnë organizatat, aspektet kyçe të Menaxhmentit të tyre dhe ambientin e jashtëm në të cilin ato operojnë;
- Të kenë një mjedis ku ata mund t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre interpersonale dhe komunikative;
- Të kenë një bazë të fortë për studime të mëtejshme dhe për punësim;

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të nevojshme për funksionet biznesore si në vijim: ekonomi, menaxhment, financa, biznes dhe menaxhment në kontekstin global, parimet e kontabilitetit, financat e korporatave, Menaxhmentin strategjik, Menaxhmentin e burimeve njerëzore dhe marketing;
- Ka njohuri të fushave funksionale të ekonomisë dhe menaxhmentit, hulumtimet dhe inovacionet aktuale, trendet e ardhshme si dhe ndikimin e këtyre ndodhive në teori dhe praktikë.
- Ka njohuri dhe të kuptuarit e situatës kombëtare, rajonale dhe globale ekonomike në treg;
- Ka njohuri të teorive menaxheriale, analizave dhe raportimeve;
- Fiton një bazë të fortë për atë se si të zhvillohet më shpejt ekonomia dhe është i gatshëm për karrierë dhe studime postdiplomike që kanë të bëjnë me ekonominë dhe menaxhmentin ose me drejtime tjera të përafërta;
- Ka njohuri për mjetet e ndryshme të nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale;

### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të shkruar në mënyrë profesionale dhe zhvillim të mëtutjeshëm të detyrave në ekonomi dhe menaxhment dhe implementimi i tyre në jetën reale;
- Aftësi për të ndihmuar në formulimin dhe zbatimin praktik të planeve të suksesshme të Menaxhmentit të përgjithshëm dhe strategjive;

### Aftësitë për të vlerësuar

- Të mendojnë në mënyrë kritike dhe t'i aplikojnë dijet teorike dhe praktike dhe përvojën për identifikimin dhe analizën e problemeve ekonomike;
- Të analizojnë në mënyrë kritike dhe ta vlerësojnë identifikimin e mundësive menaxheriale;

### Aftësitë e komunikimit

- Të tregojnë se e kuptojnë dinamikën individuale dhe grupore;
- Të funksionojnë në mënyrë efikase në punën ekipore;
- Të merren në mënyrë efektive me njerëz që kanë prejardhje të ndryshme në aspektin shoqëror, ekonomik, kulturor dhe fetar;
- Të demonstrojnë mirëkuptim dhe ndjeshmëri për përgjegjësitë etike, sociale dhe ligjore të kompanive;
- Të shfaqin idetë e biznesit në mënyrë efektive;
- Të demonstrojnë aftësi kyçe negociuese;
- Të interpretojnë të dhënat e biznesit dhe treguesit ekonomikë;

### Aftësitë e të mësuarit

- Mund të hulumtojnë dhe t'i dektektojnë burimet e të mësuarit;
- Mund të trajnohen për mësim individual dhe ekipor;
- Kanë aftësinë për të përdorur literaturë shkencore dhe të bëjnë analiza të opinioneve dhe vlerësimeve të autorëve të tjerë;

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [CBE-102] [6.0 SETK] **Parimet e marketingut**
- [CBE-101] [6.0 SETK] **Hyrje në ekonomi dhe biznes**
- [CBE-103] [6.0 SETK] **Parimet e menaxhmentit**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## **Semestri 2**

- [CBE-201] [6.0 SETK] **Parimet e kontabilitetit**
- [CBE-202] [6.0 SETK] **Matematikë biznesi**
- [CBE-203] [6.0 SETK] **Mikroekonomi**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë shqipe/maqedonase**

## **Semestri 3**

- [CBE-301] [6.0 SETK] **Statistika**
- [CBE-302] [6.0 SETK] **Kalkulus biznesi**
- [CBE-303] [6.0 SETK] **Makroekonomia**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## **Semestri 4**

- [CBE-401] [6.0 SETK] **Menaxhmenti i operacioneve**
- [CBE-402] [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar**
- [CBE-403] [6.0 SETK] **Marketing menaxhment**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - Gjuhë angleze për qëllime specifike 2**

## **Semestri 5**

- [CBEM-603] [6.0 SETK] **Sjellja organizative**
- [CBEM-502] [6.0 SETK] **Menaxhmenti i burimeve njerëzore**
- [CBEM-503] [6.0 SETK] **Hulumtimet e tregut**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## **Semestri 6**

- [CBEM-601] [6.0 SETK] **Menaxhmenti strategjik**
- [CBEM-602] [6.0 SETK] **Dizajni dhe menaxhmenti i produktit**
- [CBEM-501] [6.0 SETK] **Biznesi i vogël dhe sipërmarrësia**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

## **Semestri 7**

- [EBE-401] [6.0 SETK] **Sjellja e konsumatorëve**
- [CBEM-701] [6.0 SETK] **Teoria e vendimmarrjes**
- [CBEM-702] [6.0 SETK] **Menaxhmenti i ndryshimeve dhe inovacionit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

## **Semestri 8**

- [EBE-404] [6.0 SETK] **Marketingu i shërbimeve**

- [CBEM-801] [6.0 SETK] **Udhëheqja**
- [EBEM-501] [6.0 SETK] **Menaxhmenti korporativ**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [CBE-802] [6.0 SETK] **Projekt - Studimi i rastit**

## Description of courses

### Lëndë obligative

#### • Parimet e marketingut

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njohohen me konceptet themelore të cilat janë ndërtuar në funksionet e marketingut në organizatat bashkëkohore. Fokusi është vendosur në konceptet, si dhe në çështjet lidhur me marketingun e prodhimeve dhe shërbimeve të konsumatorëve. Në mënyrë më specifike, qëllimi është që studentët ta njohin mjedisin e marketingut nëpërmjet analizës së tregut, që pastaj të implementohen strategjitë e suksesshme të marketingut në atë mjedis. Studentët gjithashtu do të mund t'i implementojnë konceptet shkencore për dizajnimin e planit të marketingut për produktin e tyre. Kjo lëndë u mundëson studentëve të njohohen me aktivitetet e ndryshme në fushën e marketingut, të cilat kontribuojnë që kompania të jetë më konkurrense dhe më e suksesshme në treg.

#### • Hyrje në ekonomi dhe biznes

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP) si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

#### • Parimet e menaxhmentit

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njohohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: - T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. - Të mendojnë në mënyrë efektive që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtejshme.

#### • Parimet e kontabilitetit

Qëllimi i programit të lëndës është t'u ndihmojë studentëve ta kuptojnë thelbin e kontabilitetit, t'i mësojnë bazat e kontabilitetit, konceptet dhe parimet e kontabilitetit. Në mënyrë më specifike, studentët të fitojnë njohuri dhe t'i kuptojnë raportet financiare, komponentët e tyre, rregullat themelore të evidentimit të të dhënave kontabël, përdorimin e dokumenteve kontabël.

#### • Matematikë biznesi

Qëllimet e lëndës matematikë e biznesit janë si në vijim: - Studentët të aftësohen ta zbatojnë sistemin e ekuacioneve lineare për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga lëmi i biznesit dhe ekonomisë. - Studentët të aftësohen t'i zbatojnë njohuritë e tyre për modelet lineare dhe vargjet e shumta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në biznes dhe ekonomi. - Studentët të fitojnë njohuri të avancuara në përlogaritjen e shkallës së ndërlikuar të kamatës, depozitave periodike, të rentave periodike, huave dhe vendimeve financiare.

#### • Mikroekonomi

Nëpërmjet kësaj lënde arrihen njohuri themelore për fenomenet ekonomike dhe për terminologjinë universale globale mikroekonomike. Ndiqen dhe analizohen qasjet teorike që mundësojnë të arrihet pasqyra vetanake për zgjidhjet e mundshme aplikative për problemet e prodhimit, këmbimit dhe organizimit të ndërmarrjeve individuale, degës ose tregut të veçantë. Komponentët e zhvillimit japin një dimension dinamik pa të cilët qasjet më pak komplekse do të ishin të papërdorshme. Bazat e mikroekonomisë mësohen në tërë botën si pjesë e përpjekjeve universale që të përafrohen dhe të definohen problemet e ngjashme dhe të vijë deri te mundësia që ato të zgjidhen në mënyra të ngjashme gjithkund në botë, por edhe për të ardhur deri te informacionet të cilat mundën në nivelin agregat të

ndihmojnë në formulimin e qëllimeve makroekonomike dhe të elementeve strategjike të planifikuara. Kjo është pjesë e nevojës që të ndërtohen shoqëri të ngjashme globale në të cilat kontaktet e shpeshta biznesore, politike, afariste do të jenë të njohura për të gjithë pjesëmarrësit dhe do të zgjidhen në të njëjtën mënyrë duke përdorur instrumente të njëjta komplementare të cilat gjithëkund janë të përdorshme.

- **Statistika**

Qëllimi i programit është që studentët të fitojnë njohuri që të jenë të aftë: - Ta përdorin analizën deskriptive gjatë analizës së të dhënave. - Ta përdorin gjasën dhe ndryshimet e rastit në zgjidhjen e problemeve të biznesit. - Ta kuptojnë përfundimin statistikor i cili paraqet bazë për interpretimin e rezultateve dhe sjelljen e vendimeve afariste. - T'i shfrytëzojnë korrelacionin dhe regresionin e thjeshtë dhe të përbërë. - T'i dinë bazat e analizës së variancës. - T'i kuptojnë bazat e numrave indeksues dhe metodat e analizës së serive kohore Parakushte për ta regjistruar këtë lëndë: Matematika e biznesit.

- **Kalkulus biznesi**

Qëllimi i programit është t'i aftësojë studentët: - Të dëshmojnë që kanë njohuri dhe kuptim për varësitë ndërmjet madhësive të cilat të cilat zbatohen në biznes dhe ekonomi dhe modelet e thjeshta matematikore. - T'i identifikojnë relacionet ndërmjet kalkulusit diferencial dhe funksionet e biznesit dhe ekonomisë. - T'i aplikojnë këto relacione për studimin e varshmërive ndërmjet madhësive në biznes dhe ekonomi. - Ta aplikojnë kalkulusin diferencial për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të cilat aplikohen në biznes dhe ekonomi. Parakushte për ta regjistruar këtë lëndë: matematikë biznesi

- **Makroekonomia**

Studenti të do të përfitojnë njohuri për: - Termet dhe kategoritë makroekonomike, të cilat janë parakusht për funksionimin e një ekonomie nacionale e cila është pjesë e një sistemi të zgjeruar ekonomik global. - Rëndësinë e indikatorëve kryesorë makroekonomikë siç janë: bruto prodhimi kombëtar, të ardhurat kombëtare, rritja ekonomike, ciklet ekonomike, investimet dhe harxhimet publike, inflacionin, papunësinë, paratë dhe bankat, buxhetin, bilancin e pagesave etj. - Instrumentet themelore të analizës makroekonomike (oferta dhe kërkesa agregate) dhe politikat makroekonomike (politika monetare dhe fiskale) etj. - Funksionimi efikas i një ekonomie kombëtare, krahasuar me ekonominë bashkëkohore të tregut, duke evidentuar në atë drejtim dallimet, ngjashmëritë dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë përkatëse; - Njohuritë nga fusha e makroekonomisë, që do t'u mundësojnë qasje të thjeshtësuar kah lëndët tjera të avancuara makroekonomike. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në ekonomi, Mikroekonomi.

- **Menaxhmenti i operacioneve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri për t'u aftësuar: - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat realizohen prodhimet dhe shërbimet. - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat kontrollohen prodhimet dhe shërbimet. - Të gjejnë një qasje të përshtatshme për zgjidhjen e secilës situatë lidhur me problemet komplekse të prodhimeve dhe shërbimeve. - T'i mësojnë aktivitetet e ndryshme në organizatë dhe funksionimin e sistemit në tërësi të Menaxhmentit operativ. - Të përgatisin dhe të sjellin vendime me të cilat krijohen kushte për prodhimet dhe shërbimet. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit.

- **Kontabiliteti financiar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve dije më të avancuar në fushën e kontabilitetit dhe implementimin e saj në sistemin kontabël të entiteteve biznesore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e kontabilitetit.

- **Marketing menaxhment**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të përgatiten t'i përdorin dhe t'i menaxhojnë 4 P-të në një organizatë ose kompani, ashtu që të jenë në gjendje t'i dizajnojnë elementet optimale të marketingut, produktin, çmimet, promovimin dhe metodat e shpërndarjes me të cilat ballafaqohen kompanitë. Në mënyrë më specifike qëllimi është të kuptohet kompleksiteti i vendimeve në Menaxhmentin e marketingut, si dhe kornizat për analizat e tregjeve, klientëve, konkurrentëve si dhe integrimi i koncepteve me planin origjinal të marketingut. Parakusht për ta regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut.

- **Sjellja organizative**

Lënda synon t'i njoftojë studentët me sjelljen organizative dhe me psikologjinë organizative. Nga kjo pikë vështrimi studentët duhet të fitojnë njohuri përkatëse nga lëmi i liderizmit, fuqisë, autoritetit, punës ekipore, konfliktit, rolit dhe

rëndësisë së organizimit të biznesit individual, etj. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit.

- **Menaxhmenti i burimeve njerëzore**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me rolin dhe rëndësinë e Menaxhmentit të burimeve njerëzore në organizatat bashkëkohore të biznesit. Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri lidhur me Menaxhmentin e procesit të burimeve njerëzore si në teorinë ashtu edhe në praktikën e kompanive ndërkombëtare dhe vendore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimi i menaxhmentit.

- **Hulumtimet e tregut**

Qëllimi i lëndës është që studentët t'i kuptojnë marrëdhëniet në mes të hulumtimit të tregut dhe vendimmarrjes, duke u njohur me proceset që shfrytëzohen në formulimin dhe zbatimin e hulumtimit të tregut. Gjithashtu, studentët do t'i kuptojnë dhe kushtet e tregut në të cilat realizohet dhe zbatohet hulumtimi, duke përfshirë edhe metodologjinë e përdorur në analizën e tregjeve. Do të analizohen teknikat dhe metodat sasiore dhe cilësore që janë në dispozicion në hulumtimin e tregut, duke përfshirë zbatueshmërinë e kufizimet tyre.

- **Menaxhmenti strategjik**

Qëllimi i kësaj lënde është: vlerësimi dhe zbatimi i elementeve kyçe të analizës strategjike, duke zgjedhur strategjinë e duhur brenda një plani fleksibël, pastaj ta stimulojë të menduarit në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë së formuluar. Qëllimi i lëndës është, po ashtu, që studentët të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike rreth çështjeve dhe problemeve që lidhen me zgjedhjen e strategjisë në mjedisin e trazuar dhe dinamik dhe të kuptojnë se nuk ka ndonjë mënyrë të vetme të drejtë për të zhvilluar strategji. Pas përfundimit të mësimit, studentët duhet të jenë në gjendje: - T'i kuptojnë teoritë dhe konceptet e Menaxhmentit strategjik. - Ta përvetësojnë fjalorin lidhur me Menaxhmentin strategjik. - T'i integrojnë njohuritë e fituara në funksionet e veçanta menaxheriale. - T'i zhvillojnë aftësitë analitike dhe të komunikimit, si dhe aftësi për punë ekipore. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit.

- **Dizajni dhe menaxhmenti i produktit**

Qëllimi i kësaj lënde është që të përgatisë studentët që të përdorin teknikat dhe metodat për hartimin dhe Menaxhmentin e produkteve dhe shërbimeve për të menaxhuar ato dhe të jenë në gjendje t'i aplikojnë ato në kompanitë e biznesit. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut.

- **Biznesi i vogël dhe sipërmarrësia**

Qëllimi i të mësuarit të kësaj lënde është që t'i ndihmojë studentët ta kuptojnë rëndësinë dhe thelbin, funksionimin dhe organizimin e ndërmarrjeve të vogla në ekonomi. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në biznes dhe ekonomi.

- **Sjellja e konsumatorëve**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri për sjelljen e konsumatorëve. Kjo lëndë do të përqëndrohet në analizimin e faktorëve që kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes për blerjen e produkteve ose shërbimeve. Një ndër aspektet më komplekse të marketingut është të kuptuarit e konsumatorit. Në zemrën e çdo biznesi është kërkesa për produkte ose shërbime. Prandaj, të kuptuarit e asaj se çfarë, kur, pse, ku dhe si konsumatorët zgjedhin produkte është e rëndësishme për tregun. Dekadat e fundit kërkesat për sjelljen e konsumatorëve përpunohen edhe në fusha të tjera siç janë psikologjia, ekonomia, antropologjia dhe sociologjia që më mirë të kuptohet sjellja e konsumatorëve.

- **Teoria e vendimmarrjes**

Qëllimet e lëndës: Teoria e vendimmarrjes ka objektivat e mëposhtme: • Studentët të mësojnë për rëndësinë e vendimmarrjes të biznesit në botën moderne. • Studentët të jenë në gjendje për të kryer vlerësimin e situatave të biznesit dhe në përputhje me të njëjtën të ofrojnë alternativa. • Studentët të pajisen me njohuri të thella rreth teknikave moderne dhe qasjeve në vendimmarrje të biznesit.

- **Menaxhmenti i ndryshimeve dhe inovacionit**

Qëllimet e lëndës : • Të dinë si të menaxhohen ndryshimet në suaza të biznesit, • T'i mësojnë metodat se si mundë të i përmirësojnë inovacionet dhe kreativitetin në suaza të ndërmarrjes, • Të kuptohet domethënia, sfidat dhe benefitet e inovacioneve të ndryshme, • Të shihen mënyrat se si mund të përmirësohet përparësia konkurruese e ndërmarrjes, • Të mësohen elementet dhe proceset e zhvillimit të mënyrave alternative të shfytëzimit të dijes në krijimin e përparësive konkurruese.

- **Marketingu i shërbimeve**

Objektivi kryesor i lëndës është që ta zhvillojë të kuptuarit menaxherial të marketing - shërbimeve. Lënda do t'i ndihmojë studentët ta përmirësojnë njohuritë e tyre në hartimin e strategjive të marketingut për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që kanë për qëllim përbushjen e pritjeve të konsumatorëve. Qëllimi i lëndës është që të prezantohen, të diskutohen dhe të analizohen disa çështje që lidhen me ndërmarrjet shërbyese. Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi, studentët do të fitojnë njohuri për sfidat që paraqiten në shërbimet e marketingut, me çka do të identifikohen dallimet në mes shërbimeve të marketingut kundrejt marketingut në ndërmarrjet prodhuese. Lënda do t'u mundësojë studentëve t'i identifikojnë dhe t'i analizojnë komponentët e ndryshëm të marketingut miks të shërbimeve. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut.

- **Udhëheqja**

Qëllimet e lëndës: Pas ndjekjes së lëndës studentët duhet të jenë të trajnuar; • Ta përshkruajnë natyrën e lidhshimit dhe udhëheqjen VWP dhe Menaxhmentin; • Të diskutojnë për qasjet gjenerike të lidhshimit; • T'i identifikojnë teoritë e lidhshimit në botën moderne;

- **Menaxhmenti korporativ**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë nga afër studentët: me themelet teorike të qeverisjes korporative, me rëndësinë dhe rolin e qeverisjes korporative në botën e biznesit modern, si dhe me stejkholderët e qeverisjes korporative dhe studentët të fitojnë njohuri dhe t'i krijojnë qëndrimet e tyre kritike rreth stejkholderëve të qeverisjes korporative te ne dhe në botë nëpërmjet një analize krahasuese të praktikave të mira të qeverisjes korporative. Lënda e menaxhmentit korporativ do t'u mundësojë studentëve: - Të fitojnë njohuri të zgjeruara mbi korporatat dhe rëndësinë e tyre për funksionimin e shoqërive moderne. - Të fitojnë njohuri të zgjeruara për modelet e qeverisjes korporative që zbatohen në vise të ndryshme të botës bashkëkohore. - Të fitojnë njohuri dhe të aftësohen t'i krijojnë qëndrimet e veta rreth stejkholderëve kryesorë të qeverisjes korporative etj. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit.

## Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjedisëve të ndryshme profesionale. Studentët pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhë maqedonase për fillestarë 1 përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të vecanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunikimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund edhe të zbatohen edhe më tutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara si dhe detyrave të vazhdueshme përmes të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Programi për Gjuhë maqedonase 2 për fillestarë përfshin: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi I aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi I personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 1, është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione) të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për një kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive e interesave të studentëve.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë shqipe për fillestarë 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të së njëjtës, të zgjerojnë dhe përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të zotërojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, të cilat do ju mundësojnë biseda të thjeshta. Edhe pse bëhet fjalë për kurs të shkallës së dytë për fillestarë, ky është menduar të jetë fleksibil dhe t'u përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 1**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 2**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 3**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

- **Gjuhë angleze për komunikim të përgjithshëm dhe profesional 4**

Pas përfundimit të çdo niveli të kësaj lënde të përcaktuar sipas testit gjatë regjistrimit, studentët pritet të jenë në nivele të ndryshme siç është përcaktuar nga Korniza e Përbashkët Evropiane (CEF) dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe fraza që synojnë plotësimin e nevojave të një lloji konkret: të pyesin dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me identifikimin personal dhe marrëdhëniet personale; të shkruajnë dhe të flasin në lidhje me jetën e tyre të përditshme; kohën e lirë; argëtimin; financat; problemet; të pyesin dhe të përgjigjen në



lidhje me titujt universitarë, aftësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe t'u përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe ta dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptuarit; ta vlerësojnë progresin e tyre; të marrin pjesë në role dhe dialogje mbi tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ ese mbi temat në lidhje me materialin e lëndës.

#### • **Gjuhë angleze 5**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbajtjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

#### • **Gjuhë angleze 6**

Anglishtja akademike është lëndë një semestrale e cila ka për qëllim t'i mundësojë studentët me aftësitë të cilat do t'u lehtësojë të nxënit e gjuhës dhe progresin e të mësuarit të tyre në një mjedis akademik të të mësuarit dhe të nxënit. Numri i orëve është 30 (100 minuta, një herë në javë). Lënda duhet t'u mundësojë atyre t'i përdorin këto aftësi jo vetëm në gjuhën e huaj (në klasë të gjuhës amtare), por dhe në sferat e përmbajtjes. Lënda përfshin aftësitë gjuhësore, aftësitë studimore dhe në përgjithësi aftësitë e zbatueshme (dëgjim, bërje të prezantimeve gojore, ndërtim argumentesh) në detyra të veçanta. Prandaj, pas përfundimit të lëndës studentët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë në mënyrë të suksesshme prezantime me gojë, të marrin pjesë në një debat/ diskutim online duke deklaruar mendimet dhe argumentet e tyre dhe t'i japin arsyetimet e tyre në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje ta dëgjojnë dhe ta lexojnë thelbin dhe detajin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke deklaruar mendimin e tyre. Ata duhet të shkruajnë paragraf dhe ese për zgjidhje të problemit. Duhet t'i njohin shkurtesat dhe simbolet në fjalor si dhe ta praktikojnë përdorimin e fjalorit njëgjuhësor. Ata duhet të jenë në gjendje ta prezantojnë informatën vizuale në formën e prezantimeve afishe. Studentët duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë idetë kryesore dhe të dhënat mbështetëse në një tekst, dhe t'i analizojnë dhe t'i identifikojnë fjalitë e temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe t'i zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

#### • **Të folurit publik**

Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me procesin e komunikimit, përgjegjësitë etike të të folurit publik dhe llojet e ndryshme të fjalimeve informative dhe bindëse. Përveç kësaj, studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme për përgatitjen dhe mbajtjen e fjalimeve, aftësi për ta analizuar publikun, të gjurmojnë tema për fjalime, të përgatisin fjalime, e të tjera. Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike duke qenë vetëkritikë konstruktivë dhe gjithashtu kritikë ndaj fjalime të kolegëve.

#### • **Debat dhe shkathtësi prezantimi**

Nga kjo lëndë studentët: do të përfitojnë shkathtësi për diskutim dhe argumentim efektiv si dhe do të zhvillojnë vetëbesim për të folur para publikut; do të përpilojnë, do të zhvillojnë dhe do të ushtrojnë prezantimin e argumenteve në mënyra të ndryshme përfshirë punën individuale, në çifte dhe prezantime ne grupe; do të mësojnë të përdorin retorikë bindëse, me qëllim të gjetjes së argumenteve që mbështesin një pozitë të caktuar lidhur me temat aktuale; ndjekja e kësaj lënde do t'u mundësojë të njihen në mënyrë më të hollësishme me proceset e debatit formal, gjegjësisht me stilin parlamentar britanik për debate;

#### • **Studime ndëkulturne**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare,

moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të kursit Studime ndërkulturore studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Aftësitë e komunikimit**

Lënda është dizajnuar t'u mundësojë studentëve që praktikisht ta zbatojnë komunikimin ndërpersonal. Studentët do të mësojnë aftësi ndërpersonale siç janë: perceptimi, të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe ai jo verbal; do ta ushtrojnë të folurit publik, si për shembull: organizimin, prezantimin dhe bazat e të shkuarit fjalime publike. Studentët do të kenë mundësinë të praktikojnë komunikimin në grupe të vogla, duke filluar nga: lidhshipi, vetëbesimi dhe të dëgjuarit. Kursi po ashtu ofron njohuri themelore të nevojshme për ta kuptuar procesin e kërkimit të një vendi pune nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe me gojë, duke shkruar rezyme, letër motivimi dhe duke simuluar intervista.

- **Excel i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që t'i informojë studentët me aplikacionin Microsoft Excel dhe duke shfrytëzuar mundësitë që ofron ky aplikacion të jenë në gjendje të kryejnë detyra të avancuara të cilat janë ngushtë të lidhura me programin fakultativ të tyre.

- **Aftësitë të avancuara të TI-së**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi në fushën e shkencave informative dhe t'i njoftojë studentët me mundësitë që ato i ofrojnë; T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike rreth aplikacioneve të Microsoft Office (Windows, Word, PowerPoint, Excel, Access) dhe t'ju mundësojë që këto aplikacione edhe t'i aplikojnë në jetën e përditshme; T'u mundësojë studentëve të punojnë projekte praktike individuale ose në grupe.

- **Word i avancuar**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i pajisë studentët me aftësi të avancuara rreth përdorimit të Word-it dhe PowerPoint-it. Ky kurs gjithashtu u mundëson studentëve që në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte të ndryshme si dhe detyra të veçanta komplekse të cilët janë të lidhura me programin e studimeve të tyre.

- **Google Apps**

Qëllimet e lëndës janë: T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shërbimeve elektronike (cloud applications); T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri teorike dhe praktike rreth Google Docs (G-mail, dokumente, spreadsheets, prezantime, vizatime dhe formulare) dhe t'i aplikojnë ato në jetën e tyre; T'u mundësojë studentëve të punojnë individualisht ose në grupe në projekte të ndryshme drejtpërdrejt nga web browser-i.

- **Access-i i avancuar**

Bazat e të dhënave (databases) janë mjete ideale për ndjekjen e vëllimeve të mëdha. Microsoft Access-i është një mjet mjaft i fuqishëm dhe i popullarizuar i cili përdoret për hartimin dhe zhvillimin e Windows-based databases. Ky kurs është i dizajnuar për përdorues të rinj të Access-it ku janë të përpunuara funksionet e nevojshme për të punuar me bazat e të dhënave.

- **Desktop publikimi**

Qëllimi i kësaj lënde është hartimi dhe përpunimi i grafikave raster dhe vektor përmes programeve kryesore të Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe hartimi dhe botimi i materialeve komerciale për shtyp duke përdorur Adobe InDesign.

- **Publikimi ueb**

Zhvillimi i një ueb faqeje qoftë edhe e thjeshtë në përputhje me standardet aktuale kërkon njohuri të gjuhës së Hypertext Markup (XHTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumë faqe ueb përdorin imazhe qoftë në formë të banerëve, sustave, logove, fotografive apo skenimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e destinuar për ueb dhe për t'iu mundësuar krijuesve që t'i përdorin këto imazhe për të zvogëluar madhësinë e fajllit. Fireworks gjithashtu ofron një integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo seri ofron një hyrje të plotë në XHTML, CSS dhe krijimin e grafikës për ueb.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma

morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërime të rrjedhshme, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuha shqipe për qëllime specifike**

Lënda ka për qëllim përmirësimin dhe përsosjen e të shprehurit në gjuhën shqipe, qoftë me gojë ose me shkrim. Në mënyrë të veçantë lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me terminologjinë specifike, mundësitë e përdorimit të saj, me gabimet më të shpeshta në të folurit e përditshëm, por edhe për komunikim në rrethana specifike. Studentët do të njoftohen me kushtet në të cilat ata rregulla hyn në përdorim, në mënyrë që mund ti përdorin jo vetëm për detyrat në lidhje me këtë temë, por edhe në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjesë të shkruar do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimitdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën maqedonase**

Pas mbarimit të kësaj lënde, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të përshtatshme dhe komunikim të avancuar në gjuhën maqedonase me theks të veçantë në aftësitë e të shkruarit. Pas kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm. Për më tepër, studentët do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shkruarit në më shumë nivele dhe në këtë mënyrë do të bëhen më të sigurt dhe më kompetentë gjatë të shkruarit në gjuhën maqedonase. Studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin konkludime. Studentët, gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi për shkrim dhe komunikim të shkëlqyer në gjuhën maqedonase.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën shqipe**

Në fund të çdo niveli studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë ese dhe punime kërkimore bazuar në rregullat e mësuara gjatë ligjëratave. Më konkretisht, nga studentët pritet që t'i mësojnë funksionin, strukturën dhe llojet e ndryshme të paragrafëve, mënyrat se si të zgjedhin tema për punime kërkimore, si të grumbullojnë materiale, rregullat se si t'i dokumentojnë referencat e të arrijnë deri tek modeli përfundimtar.

- **Gjuha gjermane (niveli 1-4)**

Pas përfundimit të çdo niveli nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane."

- **Mbrojta e ambientit**

Qëllimet e lëndës janë: T'i njoftojë studentët me problemet kryesore të mjedisit; T'i njoftojë studentët me rolin e njeriut si faktor kyç në procesin e ndotjes dhe mbrojtjes së ambientit; T'i njoftojë studentët me ndikimin e ndotësve të ndryshëm të ambientit në shëndetin e njeriut, veprimtarinë profesionale dhe aftësitë organizuese të faktorit njerëzor; Krijimi i shprehive pozitive ndaj ambientit dhe ngritja e vetëdijes për një mjedis më të shëndetshëm dhe më të pastër; Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar dhe konventat ndërkombëtare mbi mjedisin; Hyrje në politikat globale kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit; Mjedisi si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Roli i shoqërisë në mbrojtjen e mjedisit; Njoftimi me rreziqet kryesore për një mjedis të shëndetshëm; Njoftimi me Strategjinë kombëtare të mjedisit në Republikën e Maqedonisë.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Kjo lëndë ofron mësim praktik të orientuar drejt rezultateve për kërkim. Po ashtu lënda i aftëson di ta fitojnë dhe si ta mbajnë vendin e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë aftësi të përshtatshme për vende pune moderne. Detyrë kryesore do të jetë përpilimi i CV, shkrimi i letrës së interesit/kërkesës, aftësitë për të intervistuar, komunikimi

zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile oficiale për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do t'i përfshijë kjo lëndë janë: si të bëhet vetëvlerësimi, si të menaxhohet konflikti midis dy zyrave dhe si të kërkohet në mënyrë aktive promovimi. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jene të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të mbrendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Dhe do t'i nxisë që të kontribuojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Anglishtja e biznesit 1**

Studentët do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Anglishtja e biznesit 2**

Studentët do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Plani i biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Menaxhmenti i investimeve**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri teorike dhe shkathtësi praktike në sferën e investimeve dhe të vendimeve për investime në ndërmarrjet në vend dhe në botën bashkëkohore. E gjithë kjo arrihet përmes një shqyrtimi të veçantë të analizës së investimeve me theks në format dhe motivet e ndryshme të investimeve dhe të procesit të investimeve, të vlerësimit të fizibilitetit të projekteve të investimit deri në vendimin e investimeve të tyre. Gjithashtu ky kurs synon të sjellë metoda moderne për përcaktimin dhe zgjedhjen më të efektshme të projekteve reale të investimeve që do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve më pozitive financiare; analizën e praktikave bashkëkohore dhe tendencat për kategori delikate të Menaxhmentit ekonomik në investime vitet e fundit dhe proceset investuese. Këto çështje u mundësojnë studentëve qasje më të lehtë për sipërmarrje biznesi, mundësi për të marrë përsipër Menaxhmentin e financave në biznesin e tyre familjar, ose qasje më të lehtë te punëdhënësi. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit

- **Menaxhmenti i projekteve**

Qëllimi i lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajtohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të Menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës ose të idesë krijuese në një projekt real e të dokumentuar i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e menaxhmentit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjesisë korporative sociale në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjesisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **International Marketing**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që ta zhvillojë të kuptuarit menaxherial të marketingut ndërkombëtar. Lënda do t'i ndihmojë studentët t'i përmirësojnë aftësitë e tyre analitike, vendimmarrjen dhe zbatimin e tyre në hartimin e planit ndërkombëtar të marketingut. Përqendrimi do të jetë në çështjet e Menaxhmentit dhe çështjet e marketingut me të cilat përballen kompanitë që veprojnë në shumë pjesë të botës. Në mënyrë të veçantë, përmes këtij kursi do të shqyrtohet roli i marketingut në tregjet botërore dhe do të bëhet një përmbledhje e arsytimit të tij teorik, do të jepet një pasqyrë e biznesit në kontekstin ndërkombëtar, siç janë struktura, problemet e mundësitë, sfidat si dhe kushtet politike, kulturore, ligjore dhe ekonomike jashtë vendit, etj. Studentëve do t'u mundësohet të tregojnë se si t'i menaxhojnë kanalet e marketingut dhe me format e komunikimit të marketingut. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut.

- **Zhvillimi i karrierës**

Kjo lëndë ofron praktikë dhe rezultate të orientuara kah kërkimi, fitimi dhe mbajtja e punës. Ka për qëllim që studentëve t'u sigurojë shkathtësi përkatëse për nevojat e vendeve moderne të punës. Detyrë specifike do ta kenë përpilimin efektiv të CV-së, shkrimin e letrës së interesit/kërkesës, shkathtësi për të intervistuar, komunikimin zyrtar në zyrë (memorandume, e-maile zyrtare për mbikëqyrësit, konsumatorët, raporte e të tjerë). Elemente shtesë që do të përfshihen në këtë lëndë janë: si të zbatohet vetevaluimi, qeverisja e konflikteve interzyrtare dhe si të kërkohen aktivisht promovimet. Aftësitë e fituara në këtë lëndë do të jenë të zbatueshme edhe në procesin e kërkimit të punës në përgjithësi.

- **Promocioni**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me procesin e promovimit të aspekteve teorike dhe menaxheriale. Konkretisht, qëllimi është: - T'i zhvillojë aftësitë e studentëve për të mësuar dhe për të zbatuar komponentët e promovimit miks: reklamat, shitjen individuale, promovimin e shitjes dhe marrëdhëniet me publikun. - T'i zhvillojë aftësitë e studentëve për të qenë të ndjeshëm ndaj çështjeve ligjore dhe etike që lidhen me promovimin. - Të përdoret informacioni për nevojat e tyre për të bërë një strategji promovuese Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut.

- **Distribuimi dhe metodat e shitjes**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptin e shitjes dhe distribuimit, dallimet midis këtyre dy veprimtarive, si dhe metodat moderne të përdorura në ekonominë e tregut në procesin e shitjes dhe efikasitetin e shpërndarjes, kanalet e shpërndarjes, kriteret dhe strategjitë e shpërndarjes.

- **E-tregtia**

Qëllimet e programit të lëndës: - Kuptimi dhe aplikimi i koncepteve të tregtisë elektronike - biznesi elektronik. - Identifikimi i nevojave të biznesit për përshtatjen e ndryshimeve të vazhdueshme në mjedis dhe të rëndësishme për inkorporimin e teknologjisë informative në proceset më të rëndësishme të biznesit. - Përmirësimi i efikasitetit të tyre operacional që të transformohet në një përparësi konkurruese. - Zhvillimi dhe planifikimi strategjik, administrativ dhe operativ për bizneset e reja apo përmirësimi i fushave ekzistuese me teknologjitë e tyre. - Të shpjegohen: rritja e E-tregtisë deri më sot, kuptimi biznes konsumator dhe modeli biznes- biznes, duke shfrytëzuar teori relevante të biznesit, menaxhmentit dhe nga shkencave sociale. - Të hulumtohen: ndërveprimi midis trendeve teknologjike dhe sociale në biznes konteksti shoqëror i E-tregtisë, duke përfshirë edhe përhapjen e rrjeteve sociale si dhe web zhvillimet 2.0.

- **Teoria e lojës**

Qëllimi i kësaj lënde është t'u mundësojë studentëve të njohohen me teorinë jokooperative të lojërave dhe si shfrytëzohen ato në modelimin dhe analizën e situatave interaktive.

- **Bazat e biznesit ndërkombëtar**

Objektivat specifike të lëndës fillojnë duke analizuar rolin dhe ndikimin e bizneseve ndërkombëtare në zhvillimin ekonomik kombëtar. Gjithashtu, lënda do të shpjegojë se si faktorët ekonomikë, politikë, ligjorë dhe financiarë ndikojnë në aktivitetet ndërkombëtare të biznesit, do të diskutohet se si kultura dhe dallimet në sjellje ndikojnë në praktikat e biznesit të vendeve, dhe se si këto dallime mund të zgjidhen duke përdorur strategjitë e duhura. Do të diskutohen edhe teorinë e tregtisë ndërkombëtare dhe si ndikojnë vendimet e qeverive në tregtinë ndërkombëtare.

Më në fund lënda do të fokusohet në vlerësimin e efekteve të marrëveshjeve rajonale të tregtisë dhe integritimeve ekonomike në vendet në zhvillim.

- **Menaxhmenti financiar**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi në fushën e Menaxhmentit financiar, si dhe të pajisen me dije bashkëkohore teorike dhe me përvoja të analizës së koncepteve themelore të financave për korporatat, të përgatiten për projekte financiare dhe reale të investimit dhe për vlerësimin e tyre përmes dimensionit kohor të parasë. Qëllimi i lëndës vazhdon me aftësimin e studentëve se si të përdorin burime adekuata të financimit, si ta bëjnë Menaxhmentin e kapitalit dhe përcaktimin e strukturës së duhur në mënyrë efektive, pastaj përcaktimin e politikave të përshtatshme të shpërndarjes së fitimit dhe dividendës, politikën e planifikimit financiar dhe parashikimin. Arritja e qëllimeve të përcaktuara të lëndës, studentëve u krijon mundësi të reja për qasje konkurruese në tregun e punës ose i aftëson që në mënyrë më efektive të bëjnë Menaxhmentin e bizneseve të veta reale.

- **Menaxhimi i riskut**

Ky kurs është hartuar për të dhënë një kuptim bazë të menaxhimit të riskut. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të menaxherit të riskut, qëndrimit të investitorëve ndaj riskut, burimeve të risqeve (identifikimit dhe kategorizimit), si të aplikohet menaxhimi i integruar me risqet përmes përdorimit të qasjeve dhe teknikave bashkëkohore, matjes dhe vlerësimit sasior dhe cilësor të riskut, teknikave probabilitare, diversifikimit të riskut, dhe të ngjashme si në bizneset financiare ashtu edhe në ato jofinanciare.

- **Menaxhmenti i sistemeve të informacionit**

Nëpërmjet kësaj lënde jepet një hyrje e gjerë për sistemet e informacionit edhe prizma organizative dhe sociale. Qëllimi është që studentët të fitojnë një ekuilibër të duhur të perspektivave teknike dhe organizative që do të shërbejnë si bazë për studime të mëtejshme në këtë fushë.

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit shumica e kompanive përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'iu përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimit, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negociimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhmenti i tërësishëm i cilësisë**

Qëllimi i kësaj lënde është ta nxjerrë në pah rëndësinë e teknikave të MCT, rëndësinë e tyre si dhe anët pozitive të përdorimit të tyre në mënyrë me qëllim që në të ardhmen e afërt ta shohim një pasqyrë krejtësisht të re të kompanitë në Maqedoni.

- **Financat publike**

Qëllimet e programit mësimor: - Studentët të fitojnë njohuri të financave publike si një mjet i rëndësishëm i politikave makroekonomike, si një instrument themelor për funksionimin e një ekonomie kombëtare, si një tërësi dhe si një nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit. - Studentët të fitojnë njohuri për të mirat publike dhe të dalat, eksternalitet, për shpërndarjen e të ardhurave publike, alokimin dhe rialokimin e të ardhurave, të aspekteve krahasuese të financave publike në vendet e zhvilluara dhe atyre në tranzicion, për specifikat e sistemeve fiskale të Maqedonisë, tendencat dhe sfidat e tyre, decentralizimit fiskal etj. - Studentët të fitojnë njohuri për buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore si instrumente kryesore të politikës fiskale, për procedurat përgatitjes, miratimit, zbatimit dhe kontrollit të buxhetit dhe për teknikat e buxhetit si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror. - Te studentët të krijohet një pasqyrë e qartë lidhur me funksionimin e një sistemi fiskal, në aspektin e teorive të ndryshme fiskale me të cilat mund të bëjnë krahasime të ndryshme dhe për të gjetur pika të përbashkëta të funksionimit të këtyre sistemeve në vende të ndryshme. - Studentët të njoftohen me treguesit kryesorë të politikës fiskale në Republikën e Maqedonisë, duke krijuar një bazë të dhënash në kuadër të trendeve fiskale afatgjate në RM, duke inkurajuar studentët që të punojnë seminare të pavarura dhe ese mbi politikën fiskale. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Hyrje në biznes dhe ekonomi. Mikroekonomi. Makroekonomi.

- **Kontabiliteti menaxherial**

Qëllimi i programit është që studentët të fitojnë njohuri të kontabilitetit, të cilat shfrytëzohen nga menaxherët për marrjen e vendimeve. Në mënyrë më specifike, të njihen studentët me konceptet e kontabilitetit për nevojat e menaxherëve dhe me mjetet e nevojshme për marrjen e vendimeve menaxheriale. Parakusht për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e kontabilitetit.

- **Menaxhmenti i zinxhirit të furnizimeve**

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: - Ta kuptojnë mënyrën e Menaxhmentit të zinxhirit të furnizimeve. - T'i identifikojnë elementet kryesore të Menaxhmentit të zinxhirit të furnizimeve dhe lidhjen e tyre me zinxhirët e krijimit të vlerës shtesë në prodhimtari dhe rrjetave të vlerave. - Ta shfrytëzojnë potencialin e sistemit informativ për mbështetje të zinxhirit të furnizimeve dhe të zinxhirit të krijimit të vlerës shtesë në prodhimtari. Parakushte për të regjistruar këtë lëndë: Parimet e marketingut dhe Parimet e menaxhmentit.

- **E drejta tregtare**

Qëllimi i lëndës mësimore është që studentët të fitojnë njohuri themelore të së drejtës afariste. Në këtë mënyrë, studentët njoftohen me: rregullat juridike për kryerjen e aktivitetit të biznesit, mënyrën e organizimit të subjekteve afariste, kushtet për krijimin dhe regjistrimin e subjekteve afariste dhe tregtarin individual, si dhe me mënyrën e përfundimit të subjekteve afariste, me mënyrat për themelimin e raportit afarist-juridik, me kushtet për krijimin e këtyre marrëdhënieve, efektet dhe pasojat, punën me letrat me vlerë: mënyrat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, mënyrat e mbrojtjes së subjekteve afariste nga konkurrenca e joluajale: mënyrat e mbrojtjes së konsumatorëve etj.

- **Menaxhmenti bankar**

Qëllimi i lëndës: Lënda Menaxhmenti bankar ofron një kuptim të operacioneve tregtare të bankave. Ato janë kompani qëllimi kryesor i të cilave është që të krijojnë fitim nga vendosja e fondeve të huaja që bankat mbledhin dhe të përqendrohen në sektorin jo-bankar. Sigurimi vendosje në emër të vet dhe për bankat e veta llogari të krijuar një seri të instrumenteve të borxhit, dhe asetet e tyre janë investime në produkte që kanë një rrezik më të madh ose më të vogël. Produktet e tyre optimizojnë rezultatet financiare duke zgjedhur investimet që japin efekte të mëdha ekonomike direkte dhe indirekte. Lënda duhet t'u prezentojë studentëve paraqitjen e metodave të shumta për të relativizuar rreziqet si përqëndrimin e aktiveve financiare (detyrimeve) dhe vendosjen e asetëve (të arkëtueshmeve).

- **Planifikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me sistemin e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes, i cili është një mjet i rëndësishëm dhe i zbatueshëm në të gjitha sektorët e organizatës, duke përfshirë kontabilitetin dhe financat, burimet njerëzore, shitjen dhe shpërndarjen, prodhimin, furnizimin etj. Ky është një sistem ndërfunksional, i orientuar në procese, në kohë reale dhe i bazuar në praktikën më të mira në industri, nga shërbimet e deri te prodhimi. Është e rëndësishme që studentët të fitojnë njohuri të këtyre sistemeve ngase do t'u ndihmojnë në karrierë, ku mund të punojnë si ERP përdorues, auditorë, këshilltarë, dhe / ose zhvillues programesh.

- **Marketingu i çmimeve**

Lënda i përgatit studentët për zgjidhjen e çështjeve strategjike dhe taktike të lidhura me çmimet dhe për identifikimin e ndryshimeve në praktikën që kontribuojnë në fitime nga çmimi. Çmimet paraqesin një nga faktorët më të rëndësishëm për menaxherët për të maksimizuar fitimet. Megjithatë, kjo vlerë shpesh qëndron e pashfrytëzuar në shumë organizata. Menaxherët shpesh nuk kanë një kuptim të qartë se si të përmirësohet vendosja e çmimit brenda kompanive dhe industrive të tyre dhe si t'i aplikojnë këto njohuri te produktet e reja. Kursi do të jetë një përzierje e teknikave analitike për marketing, strategji marketingu, analiza statistikore dhe teori ekonomike për të përshkruar qasjet që janë të dobishme për një zgjidhje optimale rreth çmimeve. Disa shembuj të pyetjeve që kursi do të mundohet t'u përgjigjet janë: si e përcakton një kompani çmimin për një produkt të ri? Si një kompani vlerëson nëse çmimi aktual është i përshtatshëm? Çfarë paraqet vlerë te çmimet? Cila strategji është optimale e çmimit? Si mund një kompani të shmang një luftë të çmimeve? Etj.

- **Modelet dhe metodat matematikore në ekonomi**

Lënda Metodave dhe modelet matematikore në ekonomi është dizajnuar për të analizuar në mënyrë kuantitative konceptet makroekonomike dhe si e tillë përdor një sërë metodash kuantitative për modelimin dhe optimizimin e çështjeve makroekonomike. Lënda përfshin: analizën dhe modelet ekonomike; modelet agragate makroekonomike; modelet e politikave fiskale; modelet funksionale të investimeve; modelimin e politikave fiskale; modelet e inflacionit; modelet e rritjes ekonomike; modelet e tregjeve financiare; analizën kros-sektoriale.

- **Menaxhmenti ndërkombëtar**

Qëllimet e lëndës: - T'i ndihmojë studentët t'i kuptojnë në përgjithësi variablat ekonomike, socio-kulturore dhe politike të cilat ndikojnë në biznesin ndërkombëtar. - Ta kuptojnë dallimin midis ndërtimit, mirëmbajtjes dhe modifikimit global në krahasim me strategjitë ndërkombëtare që duhet shfrytëzuar në biznesin ndërkombëtar. - Të mësojnë si të bëhet analiza e shpenzimeve në aspekt të punës në tregjet globale - Ta bëjnë analizën SWOT për kompani ndërkombëtare të ndryshme si dhe të jenë në gjendje të njohin tregje të reja, - Ta kuptojnë domethënien e biznesit ndërkombëtar dhe shfrytëzimin të komunikimit global - Të definojnë dhe të shfrytëzojnë strategji të ndryshme për vlerësimin e investimeve të përbashkëta, bashkimin dhe blerjen e kompanive të reja me qëllim të qasjes në tregje të reja. - Të dinë të sjellin

vendime rreth segmentimit të tregjeve si dhe mënyrën se si të qasen tek ato.

- **Menaxhmenti i institucione publike**

Qëllimet e lëndës: Institucionet publike janë rezultat i kontratës shoqërore t'i përmbushin nevojat e përbashkëta të një bashkësie. Ato financohen nga buxheti i të hyrave publike, ndërkaq kanë karakter të nevojës publike (të zakonshme). Pikërisht karakteri i bashkësisë i përkufizon ato si institucione që duhet të menaxhohen në mënyrë transparente. Transparenca i përfshin kuptimet e qëndrueshmërisë afatgjate, të llogaridhënies dhe të aktiviteteve të planifikuara dhe të Menaxhmentit të cilësisë. Sipas terminologjisë miratuar ndërkombëtarisht institucioni shenjon fubazë të "regullave të lojës përcaktuara paraprakisht në mënyrë të qartë, të cilat janë të zbatueshme dhe të dobishme për shumicën e anëtarëve të komunitetit. Mënyra në të cilën menaxhohen institucionet e tilla do të jetë objekt i analizës dhe prezantimit të kësaj lënde.

- **Menaxhmenti i prodhimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i mësojnë konceptet themelore të cilat janë të përfshira në funksionet e marketingut në organizatat bashkëkohore. Fokusi është vënë në konceptet dhe çështjet lidhur me produktet për konsumatorët. Kjo lëndë gjithashtu siguron të kuptuarit e mjedisit të marketingut duke analizuar tregun që më pastaj të zbatojë strategji të suksesshme të marketingut në këtë mjedis përmes prodhimeve apo shërbimeve cilësore. Studentët gjithashtu duhet të jenë në gjendje t'i zbatojnë konceptet shkencore për të hartuar një plan të plotë të marketingut për produktin e tyre. Kjo lëndë gjithashtu, u ndihmon studentëve të njihen me aktivitetet e ndryshme të marketingut që kontribuojnë për të qenë kompania më konkurruese dhe e suksesshme në treg.

- **Hulumtimet operacionale**

Qëllimet e lëndës: - Kujdes lidhur me përfshirjen e variablave dhe përkufizimit të tyre në suazat e matshmërisë dhe të vlerësohet se cilat të dhëna kanë të bëjnë me kuantifikimin e variablave dhe përcaktimin e ndërveprimit të tyre. - Zhvillimi i aftësisë dhe intuitës së nevojshme të menaxherëve për të njohur thelbin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre të suksesshme; - Njohja e kufizimeve në lidhje me vlerat të cilat mund të kenë këto variabla. - Komunikimi ideve dhe harmonizimi i punë ekipore - Formimi dhe zgjidhja e modeleve eksplicite me qëllime të inkuorporuara eksplicite si dhe analiza sensitive me rastin e sjelljes së vendimeve; - Identifikimi dhe regjistrimi i vendimeve alternative që ndikojnë në objektivat si dhe ndërveprimi ndërmjet tyre;

- **Ndërmarrësia e korporatave**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i ndihmojë studentët ta kuptojnë thelbin, funksionimin dhe organizimin e ndërmarrësisë në kompanitë ekzistuese si bazë për përmirësimin e pozitës konkurruese të ndërmarrjeve të mëdha në tregun e brendshëm dhe global.